



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA FIER

Nr. ____ Prot.

Fier, më ____ .03.2026

NJOFTIM

“Për shprehje interesi nga subjektet privatë për vendosjen e ekraneve LED në hapësirat publike të përcaktuara nga Bashkia Fier me qëllim reklamimin e bizneseve ose aktiviteteve kulturore e artistike”.

Bashkia Fier, në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, ligjit 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar, VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, VKB nr. 53 dt. 30.04.2025 të Këshillit Bashkiak Fier “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve Led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre” si dhe VKB nr. 125 dt. 22.12.2025 “Për një saktësim në Vendimin nr. 53 dt. 30.04.2025 të Këshillit Bashkiak Fier “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve Led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre”, fton gjithë subjektet e interesuar të paraqesin kërkesat e tyre për vendosjen (instalimin, mirëmbajtjen, administrimin teknik) e ekraneve LED në hapësirat publike me qëllim reklamimin e bizneseve ose promovimin e vlerave kulturore, turistike ose arkeologjike nëpërmjet ekraneve sipas përcaktimeve të pasqyruara në ortofoto dhe konkretisht:

- Në Veri – lindje të kryqëzimit midis rrugës “Jani Bakalli” dhe “Ramiz Aranitasi”;
- Në Veri të kryqëzimit midis rrugës “Jakov Xoxa” dhe “Vangjel Capo”;
- Pranë Urës që lidh Kishën me sheshin qendror, rruga “Jakov Xoxa”;
- Rruga “Ismail Qemali” në lindje (tek tregu);

Dimensionet e lejuara për vendosjen e ekraneve Led do të jenë 25 m² - 35 m², në përputhje me vendimet në fuqi të Këshillit Bashkiak Fier, ofrimi i shërbimeve për reklamimin në fushën e marketingut ose reklamimi i bizneseve do të jetë në fashën orare 24/24 ndërsa 60 – 180 min do të jenë të dedikuara për publikimin e aktiviteteve kulturore artistike të Bashkisë Fier.

Subjektet e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin si vijon:

- Kërkesë për shprehje interesi për vendosjen e ekraneve Led;
- Ofertë për vlerën e detyrimit të qirasë;
- Liçensë për ushtrimin e aktivitetit;
- Çertifikatën e rregjistrimit dhe çertifikatën historike të rregjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS – in dhe vërtetimin për likuidimin e detyrimeve tatimore vendore;
- Deklaratë përgjegjësie e aplikuesit;
- Përshkrimin teknik të pajisjeve që do të vendosen; (katalogë, manuale të pajisjeve, etj)

- Punë të ngjashme;
- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që subjekti/administratori nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë Bashkisë Fier brenda **dt. 20.04.2026**.